



## PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Paneli i Gjykatës së Apelit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt*, i përbërë nga gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen, shqiptoi sot aktgjykimin e parë të apelit të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK).

Paneli i Apelit la në fuqi verdiktin e fajësisë së z. Gucati dhe z. Haradinaj për frikësim gjatë procedurës penale (Pika 3), shkelje të fshehtësisë së procedurës nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare (Pika 5), dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur (Pika 6). Paneli i Apelit më tej la në fuqi, me përjashtim të gjykatësit Ambos që nuk u pajtua, verdiktin e fajësisë së z. Gucati dhe z. Haradinaj për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet kërcënimit të rëndë (Pika 1).

Paneli i Apelit prapësoi konstatimin e Trupit Gjyqësor për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi (Pika 2) dhe i shpalli të pafajshëm z. Gucati dhe z. Haradinaj për këtë Pikë.

Bazuar në konstatimet e tyre, shumica e Panelit të Apelit uli dënimin e z. Gucati dhe z. Haradinaj nga katër vjet e gjysmë të dhënë nga Trupi Gjyqësor, në katër vjet e tre muaj burgim, duke llogaritur dhe kohën në paraburgim. Paneli i Apelit la në fuqi dënimin shtesë me një gjobë prej njëqind eurosh (100 euro).

Gjatë shqiptimit të aktgjykimit, Paneli i Gjykatës së Apelit theksoi se “Është me rëndësi themelore për përmbushjen e misionit të Dhomave të Specializuara që individët të cilët vijnë për të dhënë dëshmi, shpesh lidhur me përvoja traumatike ose të vështira, ta bëjnë këtë pa pasur frikë. Mbrojtja e dëshmitarëve nga frikësimi dhe dëmtimi është në themel të çdo sistemi të drejtësisë penale, përfshirë edhe Dhomat e Specializuara. Kjo çështje gjyqësore ka të bëjë, pra, me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe sigurinë e procesit dhe sigurinë e dëshmitarëve”.

Përmbledhja e Aktgjykimit të Apelit gjendet në [faqen e internetit të DHSK-së](#).





Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Trupi Gjykses ka caktuar që deklaratat hyrëse të mbahen më 21 dhe 22 shkurt 2023. Më 21 shkurt, Kryegjykatësja do të hapë gjykimin, do të kërkojë leximin e akuzave për të akuzuarin, do ta informojë mbi të drejtat dhe detyrimet dhe do ta pyesë të akuzuarin nëse e ka kuptuar Aktakuzën dhe nëse dëshiron të konfirmojë vetëdeklarimin e tij të mëhershëm si i pafajshëm. Më pas, Prokurori i Specializuar, mbrojtësi i viktimave dhe Mbrojtja do të kenë përkatësisht nga dy orë për të dhënë deklaratat e tyre hyrëse. Seanca do të fillojë në orën 9:30 në të dyja ditët dhe do të transmetohet në internet me një vonesë. Për ata që dëshirojnë të ndjekin deklaratat hyrëse nga galeria e publikut në DHSK, në Hagë, nevojitet regjistrim paraprak.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 26 janar, Kryetarja e DHSK-së caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të shqyrtuar apelin e z. Shala kundër vendimit të Trupit Gjykses për pranimin si prova të intervistave të mëparshme të z. Shala për TPNJ-në dhe autoritetet belge. Paneli i Apelit përbëhet nga gjykatësit Mishelë Pikar, Emilio Gati dhe Nina Jorgensen.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, të enjten e shkuar Trupi Gjykses nxori programin për konferencën përgatitore për Prokurorin e Specializuar, që është caktuar të mbahet më 15 shkurt.

Në Urdhër, Trupi Gjykses ka parashtruar një numër pyetjesh për Prokurorinë dhe Mbrojtjen, të cilat do të trajtohen gjatë seancës. Në bazë të Rregullores, Trupi Gjykses mund të përcaktojë në këtë seancë, numrin e dëshmitarëve që mund të thërrasë Prokuroria, kohën në dispozicion të saj për paraqitjen e provave si dhe mund të trajtojë aspekte të tjera lidhur me paraqitjen e provave të Prokurorisë.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Trupi Gjykses, të hënën hodhi poshtë kërkesën e z. Thaçi për apelimin e vendimit të vet të mëhershëm ku rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes për të nxjerrë formularët e kërkesave të viktimave për dëshmitarët që gëzojnë edhe statusin e viktimës.

**Pyetje nga gazetarët**  
Nuk pati pyetje

